

Nr. 21 Prot.

Tiranë më 12.09.2018

Qendra Multifunktionale "New Generation"

VENDIM I BORDIT DREJTUES

Me mbledhjen e sotme, bordi i Qendrës Multifunktionale "New Generation" vendos të aprovojë planin afatmesëm të hartuar për periudhën 2018-2023.

KRYETARE E BORDIT
ILIR TAJAJ





**STRATEGJIA E ZHVILLIMIT
TË QENDRËS MULTIFUNKSIONALE
“NEW GENERATION”**

2018-2023

Shtator 2018

HYRJE

Qendra Multifunkzionale “New Generation” është një institucion i formimit profesional në fushat e parukerisë, estetikës dhe artit trupor. Misioni i Qendrës Multifunkzionale “New Generation” është të përgatisë profesionalisht specialistë në fushat që mbulon, nëpërmjet mësimdhënies me cilësi të lartë dhe praktikës profesionale, si dhe të zhvillojë arsimin dhe formimin profesional. Npwpwmjet edukimit teorik dhe praktik, New Generation përmirëson kompetencat profesionale.

Qendra Multifunkzionale “New Generation”, konsideron si një ndër pikat më të forta, elementin e punësimit të studentëve dhe kursantëve të saj. Suksesi i sfidës së përbashkët, e jona si institucion por edhe e studentëve dhe kursantëve tanë, vërteton më së miri se rruga e zgjedhur, ka qenë ajo e duhura. Me një formim të plotë shkencor dhe profesional, studentët dhe kursantëve e New Generation, kanë arritur punësimin brenda dhe jashtë vendit, thuajse 100 % në profesionet të cilat kanë qenë pasion dhe ëndërr e tyre. Bazuar në këto statistika, vihet re shumë qartë se programet e studimit që ofron Qendra Multifunkzionale New Generation, janë të suksesshëm në tregun e punës. Ato janë hartuar duke u mbështetur në eksperiencën më të mirë ndërkombëtare. New Generation jep vazhdimisht kontributin e tij si ndërmejtës dinjitoz midis studentëve dhe tregut të punës, tashmë dhe me Zyrë për: Informim/ Punësim/ Karrierë/ Trajnim gjatë gjithë jetës e cila operon brenda shkollës!

MISIONI I QENDRES MULTIFUNKSIONALE “NEW GENERATION”

Qendra Multifunkzionale “New Generation”, në gjithë veprimtarinë e saj, ka për mision:

- Të përgatisë profesionistë të nivelit të lartë, në fushat që mbulon, nëpërmjet mësimdhënies me cilësi të lartë, praktikës profesionale dhe aktiviteteve gjithëvjetoze të lidhura me profesionin.
- Të zhvillojë më tej arsimin dhe formimin profesional.
- Të ndihmojë në punësimin dhe zhvillimin në karrierën profesionale të studentëve të saj

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

- Të pajisë studentët e kursantët me dije në përshtatje me kërkesat në rritje për shërbimet në fushat e parukerisë, estetikës & artit trupor si dhe të garantojë standart të larta e bashkëkohore duke synuar përshtatjen e specialistëve të kësaj shkolle jo vetëm brenda vendit por edhe në Rajon, Europë dhe më gjerë;
- Të ofrojë studime më të specializuara edhe për profesioniste të cilët duan të plotësohen profesionalisht me informacione shtese për fushat më sipër;
- Të kryejë aktivitete të shumëllojshme të lidhura ngushtë me veprimtarinë akademike dhe programet e studimeve që zhvillon;

Programet e studimit në Qendrën Multifunkionale “New Generation” janë dizenuar që:

- Të mundësojnë studentët që të kualifikohen personalisht dhe të kenë gjatë aktivitetit të tyre në profesion qasje akademike dhe kërkimore profesionale (Long Life learning);
- Të përkrahin mësimin dhe të mësuarit aktiv, praktikën profesionale, kërkimin e të resë dhe të bukurës, si dhe të jenë njerëz me përgjegjësi sociale;
- Të jenë sa më pro-aktive në zhvillimin dhe përdorimin e metodave të reja si të mësuarit e kërkuarit alternativ dhe elektronik (e-learning);

Programet synojnë të pajisin studentët me:

- Të menduarin dhe punuarin në mësimdhënie me koncepte sa më bashkëkohore, përfshi teknika dhe trende inovatore në fushën profesionale të parukerisë, estetikës dhe artit trupor;
- Njohuri teorike të mundësuar në auditor dhe online përmes platformes për studentët, New Generation E-Learning;
- Një nivel sa më të lartë të përkrahjes dhe inkurajimit për avancim personal;
- Mundësi pjesëmarrje në organizime të ndryshme, të mësuarit përmes trajnimeve akademike/profesionale, punës në praktike dhe inovacionit;
- Përvoja solide përmes një kualifikimi të stafit në universitete të ndryshme e kualitative brenda dhe jashtë vendit si garanci për diversitet dhe cilësi;
- Një kualitet të lartë mësimdhënës, ambient, infrastrukture dhe akomodim social, duke i angazhuar ata edhe në jetë sociale e kulturore;
- Një lokacion fizik të shkollës sa më modern, të përshtatshëm dhe të arritshëm, e që garanton qetësi, fokusim, dhe ambient të përshtatshëm me standard ndërkombëtare.

Detyrat e QMNG:

Informim: Për kërkesat e tregut të punës për të gjitha nivelet e formimit, në bazë të statistikave të grumbulluara nga kontaktet me qendrat dhe sallonet.

Punësim: Ndërmjetësimi midis Qendrave estetike, Salloneve dhe studentëve tanë, me qëllim punësimin e tyre. Kjo ka funksionuar në Tiranë, qytete të tjera të Shqipërisë. Në Top List janë studentët të cilët kanë frekuentuar maksimalisht internship-in. Gjithashtu përparësi ju jepet studentëve nga shtresat në nevojë.

Karrierë: I përgjigjet kërkesave nga ish studentët e punësuar suksesshëm, për tu ngritur në nivele më të larta, në qendrat më luksoze apo për t'i dhënë konsulencë dhe mbështetje në hapjen e bizneseve të tyre private.

Trajnim gjatë gjithë jetës: Konsiston në ofrimin e mundësisë për pajisjen me informacione të reja, specializime afatshkurtra, azhurnimin me teknikat më moderne, të ish studentëve. Përveç punësimin të studentëve nëpër sallone apo qendra estetike, New Generation do të ofrojë edhe mundësinë e

vetëpunësimin nëpërmjet New Generation- START UP ZONE, i cili në 2019 - 2020 do të jetë investimi më i madh i Qendrës Multifunktionale “Neë Generation” në drejtim të inovacionit.

Neë Generation- START UP ZONE do të jetë qendra më e rëndësishme e kujdesit ndaj studentëve/kursantëve tanë në vazhdimësi, të cilët duan të bëhen **mjeshtër në profesionin** që kanë zgjedhur dhe njëkohësisht duan të bëhen **sipërmarrës të rinj**.

Pasi mbarojnë studimet, studentët/kursantët do të punojnë tashmë të pavarur me klientët, duke synuar **afirmimin si profesioniste**, rritjen e numrit të klienteve dhe krijimin e besimit të ndërsjellë. Kështu rrisin besimin në zhvillimin e qëndrueshëm të biznesit të tyre më tej.

RELACION STRATEGJIK

Qendra Multifunktionale “New Generation” ka ndërtuar tashmë një reputacion të merituar për t’i pajisur studentët me përvojë akademike, kërkimore e praktike; duke mundësuar që paralelisht me këtë t’u krijojë atyre kualifikim superior në tregun e punës. Kapaciteti, cilësia dhe vazhdimësia në procesin e të mësuarit dhe përvetësimit, si për institucionin edhe për studentët, do të jenë pika fundamentale për zhvillim të ardhshëm individual dhe institucional.

STRATEGJIA E BRENDSHME AFATMESME (3-5 VJET):

Objektivat e Organizimit Institucional:

- Krijimi i identitetit të formimit akademik, kërkimor dhe profesional për fushat që mbulon veprimtaria e Qendrës Multifunktionale “New Generation”.
- Vendosja e lidhjeve me tregun e punës që përpara diplomimit dhe konsolidimi i Zyrës për “Informim/ Punësim/ Karrierë/ Trajnim gjatë gjithë jetës” për të sjellë informacion mbi tregun e punës dhe mundësitë e punësimeve konkrete.
- Asistencë e mbështetje për kualifikim të mëtejshëm të diplomuarve dhe stafit akademik.
- Ofrim i mundësisë për vetëpunësim në një incubator inovacioni për studentët të cilët aspirojnë të jenë sipërmarrës në të ardhmen.

Objektivat e Hartimit të Programeve të Studimit:

- Përmirësimi i vazhdueshëm dhe konsolidimi i planit dhe programeve mësimore në përputhje me objektivat e formimit, problemet e verëjtura në zbatim dhe “feed- back” të marre nga studentët e stafi.
- Përshtatja me risitë dhe nevojat bazuar në tregun e punës.

Objektivat e Partneritetit me të Huaj:

- Zbatimi dhe thellimi i mëtejshëm i marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhuara me shkolla profesionale partnere apo institucione standartizues brenda dhe jashtë vendit;
- Fokusimi tek partnerët strategjikë dhe diversifikimi i marrdhënieve.
- Anëtarësimi dhe bashkëpunimi me shoqata dhe organizma vendas dhe ndërkombëtarë si edhe pjesëmarrja në aktivitete në kuadrin e këtyre anëtarësimeve.

Objektivat e zbatimit të programit të studimit (stafi, infrastruktura)

- Konsolidimi i atmosferës pozitive ekzistuese të mësimdhënies;
- Fuqizimi i laboratorëve për zhvillimin e veprimtarive cilësore në Qendrës Multifunkzionale “New Generation”;
- Pasurimi i bibliotekës së “New Generation” me tituj dhe autorë bashkëkohëkohorë dhe me teknika inovative në lidhje me profilet e ofruara të studimit.

Objektivat e konsulences, Kërkimit shkencor dhe Inovacionit:

- Gjallërimi i aktivitetit praktik, shkencor, inovacionit pranë departamenteve hulumtuese.
- Botime të reja rezultat i kërkimit shkencor dhe punimeve/teksteve të hartuara nga pedagogë e profesionistë të fushës.

STRATEGJIA E BRENDSHME AFATGJATË (2018-2023):

Objektivat e Organizimit Institucional:

- Forcimit të lidhjeve me tregun e punës dhe mbështetjes së studentëve në punësim.
- Zhvillimin e Qendrës Multifunkzionale “New Generation”; si një platformë akademiko-trajnuese.

Objektivat ne lidhje me vetepunesimin

Viti 2018: Diskutime /studim i ambientit, mbi nevojën e një hapësire inovacioni, inkubatori në funksion të studentëve të shkollës në të cilin studentët me ambicioze me dëshirën për të qenë sipërmarrës të së ardhmës të fitojnë eksperiencën e nevojshme, të praktikojnë njohuritë praktike profesionale. Gjate këtij viti, vendosja e ngritjes së një qendre të tillë në një lokacion të favorshëm në afërsi të qendrës së Tiranës.

Viti 2019: Ndertimi dhe pajisja e “New Generation Startup Zone” me mjetet dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e praktikës profesionale dhe vetëpunësimin të studentëve të shkollës.

Viti 2020: Inagurimi i inkubatorit “New Generation Startup Zone” dhe njohja e studentëve me këtë mundësi për vetëpunësimi. Hartimi i të gjithë dokumentacionit shoqëruës (modele kontratash, rregulloresh etj)

Viti 2021: Integrimi dhe përfshirja e studentëve të shkollës, vetëpunësimi i studentëve dhe aftësimi profesional në këtë inkubator për një periudhë 6-12 muaj.

Objektivat ne lidhje me integrimin me institucione starnadizuese te huaja

Viti 2018: Diskutime mbi nevojën e një bashkëpunimi me të ngushtë se sa në vitet e mëparshme me një institucion ndërkombëtar, për fuqizimin e dokumentit dhe persosjen e programit të ofruar të studimit. Synohen rrjetet europiane dhe me gjere që funksionojnë në këto fusha.

Viti 2019-2020: Lidhje e komunikimeve me institucionin CIDESCO me bazë në Zvicër (rrjeti më i madh i shkollave CIDESCO), përgatitja e dosjes së aplikimit me dokumentat e kërkuar, përmirësimi i strukturës së brendshme institucionale, përshtatja maksimale e pajisjeve dhe produkteve në funksion të praktikës studentore dhe aplikimi me dosjen e dokumentacionit të kërkuar.

Viti 2020-2021: Kryerja e një inspektimi nga specialiste të huaj mbi aplikimin e bërë nga shkolla. Synimi i marrjes së titullit “Shkollë CIDESCO në Trajnim” si institucioni i parë në Shqipëri.

Objektivat ne lidhje me përmirësimin e infrastruktures se studimit

Viti 2018: Gjetja e një ndërtese të përshtatshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit mësimor teoriko-praktik, sa më afër jetës sociale të vendit, me sipërfaqe të mëdha dhe hapësira të bollshme publike, të dedikuara për jetën studentore, larg ndotjes akustike apo zonave industriale.

Viti 2019: Fillimi i ndertimit te ambienteve te reja shkollore

Viti 2020: Vazhdim i procesit te ndertimit te ambienteve te reja shkollore.

Viti 2021: Inagurimi i ambienteve te reja.

Objektivat e Hartimit të Programeve të Studimit:

- Konsolidim të mëtejshëm në planin dhe programet e studimit e kërkimit, si dhe gjithë elementët e tjerë të lidhura me to, në përputhje me arritjen e objektivave të formimit dhe impaktit shoqëror;
- Konsolidimit të kushteve për studime të arsimit te larte profesional jouniversitar, përmes një programi kualitativ bazuar ne kurrikula ndërkombëtare të shkollave profesionale, sipas Kartës së Bolonjës;
- Marrjes së “feed-back” të vazhduar nga studentët dhe kursantët e diplomuar për të parë ecurinë dhe përmirësimet e nevojshme në procesin e formimit dhe arsimit profesional; dhe për të ndërmarrë korrigjimet përkatëse në të gjithë elementët e tyre në New Generation në përputhje me këtë “feed-back”.

Objektivat e Partneritetit me të Huaj:

- Konsolidimi i cilësisë, pranisë dhe rolit të anëtarësimit në shoqatat dhe organizmat vendase dhe ndërkombëtare pjesëmarrëse, si dhe prezencës në aktivitetet në kuadrin e këtyre anëtarësimeve.
- Thellimi i marrëveshjeve të lidhuara me shkolla profesionale partnere jashtë vendit për ndërkombëtarizimin e shkollës, shkëmbimin dhe internshipet/ praktikat profesionale.

Objektivat e implementimit të programit të studimit (stafi, infrastruktura):

- Rritja e shkallës së mbështetjes së studentëve në nevojë por cilësorë e të talentuar, duke aplikuar programe bursash sociale / lehtësime ne tarifat e studimit për këtë kategori të diskriminuar.
- Gjithashtu duke ofruar mundësinë e bursave për maturantët e talentuar, si dhe gratë e moshave 30-45 vjec nëpërmjet konkursit të përvitshem: “Fantastil, Ndiq Talentin!” dhe “Fantastil, Zgjo Talentin!”
- Krijimit të imazhit të bazuar jo vetëm tek infrastruktura, por mbi të gjitha në identitetin e filozofisë dhe praktikës së formimit, si dhe impaktit shoqëror në vend.

Objektivat e konsulencës, praktikës, kërkimit shkencor dhe inovacionit:

- Kryerjen e publikimit të studimeve cilësore ndërkombëtare shkencore, që i vijnë në ndihmë praktikës dhe informimit teorik për fushat që mbulon veprimtaria akademike e New Generation.

- Konsolidimi i produkteve dhe ambienteve të nevojshme në funksion të kërkimit praktik e shkencor, dhe inovacionit.

Strategjia e New Generation për Marrëdhëniet me Jashtë parashikon këtë plan veprimi

- Konsolidimi dhe eficientimi i partneriteteve ekzistuese dhe funksionale; si dhe krijimi i marrëveshjeve të reja pragmatike dhe të qëndrueshme të bashkëpunimit dhe ndërveprimit me institucionet publike dhe private në vend, BE dhe më gjërë në botë;
- Afrimi i profesionistëve vendas dhe të huaj, nga institucione me të cilët është arritur marrëveshja, në funksion të implementimit të risive të tregut evropian në programet e New Generation, dhe zhvillimi e konsolidimi i njohurive teorike dhe praktike;
- Krijimi i partneriteteve dhe marrëdhënieve të bashkëpunimit për kualifikim dhe diplomim të suksesshëm ndërkombëtar nga institucione standardizuese, sic është CIDESCO.

Strategjia e Përmirësimit të Cilësisë së Brendshme

Politika e Cilësisë së Brendshme përshin këto rubrika: komisionet e vlerësimit, planin e zhvillimit institucional të cilësisë, mënyrat e vlerësimit, udhërrëfyes për vlerësimin e mësimdhënies, burime dhe metoda për vlerësimin e mësimdhënies, dosja e pedagogut dhe procedurat e rivlerësimit. Mjetet përmes të cilave synohet të realizohen janë:

- Rishikimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mësimnxënies, mësimdhënies, hulumtimit dhe shërbimeve përkrahëse për studentët dhe stafin;
- Përdorimi aktiv i planifikimit dhe procesit të vetëvlerësimit lidhur me misionin e shkolles;
- Zhvillimi dhe përdorimi i komunikimit efektiv dhe punës në ekip pozitiv;
- Shpërndarja efektive, funksionimi dhe rishikimi i politikës së cilësisë si dhe procedurave dhe proceseve;
- Zhvillimi i cilësisë së lartë në mësimdhënie dhe i ambientit të punës;
- Qartësimi i planit të zhvillimit institucional të cilësisë me të gjithë stafin i cili do të kontribuojë në rritjen e cilësisë;
- Kualifikime dhe specializime të mëtejshme për pedagogët që kontribuojnë në perfeksionimin e menaxhimit të procesit mësimor.

Stafi Akademik dhe Kërkimor:

Qendra Multifunkionale “New Generation” do të ofrojë staf me këto karakteristika:

- Edukim bashkëkohor dhe përvojë në mësimdhënie disa vjecare, me prirje vlerësimi dhe orientimi drejt edukimit dhe nevojave të studentëve dhe kursantëve;
- Qasje profesionale dhe akademike për procesin mësimor duke theksuar rëndësinë e praktikës

profesionale dhe përfshirjes sa më të madhe në procese pune;

- Integrim i aftësive zhvillimore në plan-program, të reflektuara në metodat e organizimit të kursit dhe në vlerësim;
- Aftësi në krijimin e një ambienti dinamik me studentët dhe kolegët;
- Aftësim i studentëve për punë si pjesë e ekuipazhit të “New Generation” dhe si qytetar i përgjegjshëm i përkushtuar në standarte të larta, i përgatitur që të përkrahë, zhvillojë dhe realizojë aktivitete kur ti kërkohet dhe me fleksibilitetet dhe cilësi.
- Aftësi për të komunikuar në mënyrë të njëjtë si në formë të shkruar dhe atë verbale.

Programi për Mbështetje Financiare:

- Vetëpunësim i studentëve më të mirë dhe aktive në inkubatorin e inovacionit të krijuar nga New Generation.
- Angazhim sezonal ose veror në projektet televizive, shfaqje teatrore, material filmike, në fushën e Parukerisë dhe Makeup të identifikuar nga Zyra e Punesimit.
- Mundësimi në raste dhe për grupe të caktuara sociale ose të diskriminuara për studime akademike ku studentët aplikojnë për mbështetje financiare përmes Bursave.

Për të arritur këto objektiva, Qendra Multifunktionale “New Generation” duhet të plotësojë:

- Të sigurohet se plan-programi është bërë në bazë të një planifikimi paraprak të bazuar në kërkime dhe punë praktike, dhe ku studentët të kenë mundësi të kontribuojnë në zhvillimin e formës dhe përmbajtjes së plan-programit.
- Të zhvillojë dhe mundësojë lidhëshmërinë profesionale dhe sipërmarrjen në fushat e parukerisë, estetikës & artit trupor.
- Të përzgjedhe dhe rekrutojë stafin e kualifikuar akademik në fushat e mësipërme.
- Të integrojë teknika dhe metoda bashkëkohore në procesin mësimor dhe kërkim shkencor.
- Të përgjigjet nevojave të studentëve në aspektet e jetës studentorë (akademike, kërkimore dhe shoqërore).
- Të krijojë një bazë financiare të qëndrueshme që mundëson infrastrukturë e shërbime të mira për sistem modern edukimi, pasqisje e akomodim për mësim, materialet mësimore dhe mjedisin social.
- Të implementojë strategjinë e edukimit dhe kërkimit në mënyrë të vazhdueshme.



INFORMACION

Adresa: Rruga e Saraçeve (tek Selvia), Pallati 11
katësh

Tel: +355 4 24 21 840

Mob.: 069 20 37 056

Email: info@newgeneration-al.com

Website: www.newgeneration-al.com